

VENDIM
Nr.739, datë 7.11.2007

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH,
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
JAPONISË, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 6 e 14 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NOTË VERBALE

Ministria e Punëve të Jashtme i paraqet komplimentet e saj Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin ta informojë këtë të fundit, se Qeveria e Japonisë është e përgatitur të ndërmarrë, mbi baza reciproke, masat e mëposhtme nga 10 dhjetor 2007 lidhur me kërkesën për heqjen e kërkesave për vizë.

1. Shtetasit e Republikës së Shqipërisë mbajtës së pasaportave të vlefshme diplomatike, të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, që kërkojnë të hyjnë në Japoni me qëllim që të ushtrojnë funksionet diplomatike ose konsullore të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe shtetasit që mbajnë pasaportat e lartpërmendura, të cilët janë anëtarë të familjeve të tyre, pjesëtarë respektiv të tyre, mund të hyjnë në Japoni pa pasur vizë, pavarësisht nga kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në Japoni.

2.1) Shtetasit e Republikës së Shqipërisë mbajtës së pasaportave të vlefshme diplomatike, të lëshuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, që kërkojnë të hyjnë në Japoni për qëllime të tjera, të ndryshme nga ato të referuara në paragrafin 1 dhe me qëllim qëndrimin në Japoni për një periudhë që nuk i kalon nëntëdhjetë (90) ditë në vazhdimësi, mund të hyjnë në Japoni pa vizë.

2) Heqja e kërkesave për vizë sipas nënparagrafit (1), më sipër, nuk do të zbatohet për ata shtetas të Republikës së Shqipërisë të cilët dëshirojnë të hyjnë në Japoni me qëllim të kërkimit të punësimit, qëndrimit të përhershëm ose të ushtrimit të profesionit, ose ndonjë punësimi tjetër (duke përfshirë zbavitjen publike dhe sportet për qëllime përfitimi).

3) Heqja e kërkesës për vizë sipas paragrafit 1 dhe 2, më sipër nuk përjashton shtetasit e Republikës së Shqipërisë që hyjnë në Japoni nga detyrimi për t’u bindur ligjeve dhe rregullave të Japonisë lidhur me hyrjen, qëndrimin, rezidencën, daljen dhe kontrole të tjera për të huajt.

4) Qeveria e Japonisë rezervon të drejtën për të pezulluar përkohësisht zbatimin e të gjitha ose disa masave të mëparshme për arsye të politikës publike, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me sigurinë publike, rregullin dhe shëndetin. Çdo pezullim ose heqje e pezullimit do të njoftohet menjëherë te Qeveria e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet kanaleve diplomatike.

5) Qeveria e Japonisë rezervon të drejtën për të refuzuar hyrjen ose qëndrimin në Japoni për ata shtetas të Republikës së Shqipërisë të konsideruar të padëshiruar pa paraqitur motivet për vendimin e saj.

6. Qeveria e Japonisë mund të përfundojë masat e mëparshme duke dhënë më parë, një shënim me shkrim 30-ditor për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Punëve të Jashtme përfiton nga ky rast t’i përsërisë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë sigurimet e konsideratës më të lartë.

Tokio, (muaji, data, viti)